

BJH-1  
A73.

FATOS  
ARAPI

Dukke

dalë  
prej

ëndrrës

POEZI

891883-1

8JH-1  
1773

# Fatos Arapî

REDAKTORE  
BARNABY FONDO

Duke  
dalë  
prei  
ëndrrës...



POEZI

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

kişinin gibi...  
kırıslılığı  
geçmiş  
içindeki  
kayıtları  
kullanılarak  
yeni bir  
kayıtlı  
kişiyi  
yaratır.

## DJALIT TIM QË LUAN ME PËLLUMBA...

*Tani që ti i mbushe trembëdhjetat,  
tani që ti po luan me pëllumbा. —  
Me nënën grindesh ndonjë po të humbi,  
se ti dëboka nga kuzhina me fshesë...*

*Unë isha partizan  
trembëdhjetë vjeç.*

*Dhe partizan do të thotë dhe mali,  
dhe partizan do të thotë dhe uria;  
dhe partizan do të thotë shoku i vrarë  
dhe ti që s'ë beson vdekjen e tija...*

*Po mua më kish marrë malli për nënën,  
më kishte marrë për gjyshen e gjorë,  
kërkova leje dhe u nisa këmbë:  
që nga Tirana — këmbë gjer në Vlorë...  
Kur dielli perëndonte tej mbi ujëra,  
s'ë di se si u gjenda në baxhà, —  
atje më prisin tufat me pëllumbा:  
më paskësh marrë malli për ata...*

*Sqep më-sqep loznin nëpër erë,  
duar e grushte mbushur me gugitje:  
një vezë e vetme mbetur në folezë,  
përbrenda saj zokthi që çukiste.  
Çukiste zogu e nuk dilte dot...  
Përkulur mbi të me thonj e gishtrinj,  
çiflosja, thyeja lëvozhgën e fortë.*

*Automatikun hedhur krahëqafë,  
prej veze nxirrja pëllumbin e bardhë.*

*Dëgjova gjyshen që thirri përposh:  
— Uh, korba unë, paska ardhur Fatoshi...*

**1979**

## DREJT SHQIPËRISË...

Me vendim të qeverisë të Ahmet Zogut në vitin 1938, eshtrat e Naim Frashërit u sollën në Shqipëri të shoqëruara nga një kolonel xhandarmërie.

*Bosfori ishte i kaltër — ndryshe si do të ish?  
Po vinte vetë Naim Frashëri drejt Shqipërisë.*

Në bord të anijes së huaj vetëm ata dy shqiptarë.  
 Nën sqetullën e xhandarit arkëz e poetit të madh.  
 Europa shtrihej përpara, Egjeu, déti Mesdhe —  
 te bregu diku aty pranë vendi i Homerit qe.

*Babai i madh i poetëve, ai që krijoi tragjeditë,  
e ndjeu se edhe i verbër, po i errësokeshin sytë.  
Akullonte kërcënëm i xandarit mbi vdekjen  
e poetit vet, —  
dhe ishte, dreqi ta marri! — vërtet ish shekulli XX.*

*Naimi në arkëz të vogël — Naimi dhe qiejt shqiptarë.*

*Dhe fjala - fat i Dodonës: shpresë agimi të bardhë; shpirti-shqiponjë i lirisë, ndezur për jetë të jetëve; kënga-atdheu qiellor i pavdekësisë së poetëve.*

*Naimi nga arkëz e vogël shikonte kupën qiellore...  
Mbi fatin tragjik të popujve, mbi fatin tragjik  
të kombeve prap, shtrinte krahët-zgalem liria e  
pavdekshme dhe kënga...*

*Dhe bota e madhe frymë merrte e mirë, e mirë  
si zemër.*

*Bosfori ishte i kallër — ndryshe si do të ish?  
Po vinte vetë Naim Frashëri drejt Shqipërisë.*

## UNË JAM QYTETI IM...

*Njerëzit u ngjakan qyteteve:  
me udhë të gjera, të drejta,  
rrugina të ngushta, të spërdredhura  
në veten e tyre;  
me dritare — sy në shpirt:  
disa të mbyllura, të tjera të hapura...  
Duan dritë.  
Duan ajër.  
Me kulmakë të thepisur të shtëpive —  
do të mbajnë mbi vete edhe borën,  
edhe peshën e rëndë të diellit.  
Me një bajame mbirë  
te pragu i derës; një saksi karafilash të  
bardhë  
varur te pezuli i zemrës.  
Dikush me zili mban një kështjellë  
mesjetare,  
bedenat të ngrëna:  
murmurojnë nëpër kthina të saj  
zëra të gërryer përbrenda.  
Me kulla të bardha sahati,*

*kambanoret orëve të vona të natës  
kumbojnë brenda vetes.*

*Me varreza që rriten përditë,  
me stacione ku dashuritë,  
si dy gjysma cigaresh të ndezura,  
marrin ndër buzë fjalën: «Lamtumirë»...*

.....

*Unë jam qyteti im:  
një buzëqeshje diellore përmes degësh ulliri.  
Rrugë, shtëpi me zëra zogjsh,  
shkolla ku ditët e mia si nxënëse  
ulen.*

*Pas dritares përgjysmë të hapur  
një zemër, që nuk e njoh, rreh për mua —  
një zemër që kthehet nga unë, më ndjek  
si lulja diellin.*

*Me duar të ashpra, të vrara prej bujku,  
lëroj dhe tokën dhe qiellin.  
Dashuritë e gjelbra të mia,*

*shpirt i tyre, mbajnë erë portokallesh.  
Dhe unë një lumë i nënujshëm i Jonit  
çaj detin — rryma e rrëmba të kthjellta  
vërshojnë hapësirës së kripur  
që ndahet anash... Atje,  
në syrin e kaltër të detit vdes pulëbardha.*<sup>1)</sup>

---

1) Ashtu si pelikanët që kanë vendet e tyre edhe pulëbardhat, në çastet e fundit të jetës, kërkojnë pellgjet më të kaltra të detit.

## DUKE DALË PREJ ËNDRRËS...

Të pashë në èndërr mbrëmë —  
do të takoheshim sot.

Ti ishe diçka jashtë mendjes —  
dhe qeshnim të dy në një lot.

Ti ishe një dritë që ecën,  
një këngë që ecën ti ishe:  
mes dashurive të njerëzve,  
ti tokësorja mahnitëse...

Të shihja dhe zemrën ma ndrydhëte  
një dhimbje burri e ligjshme:  
dashuria ime ndryshtë  
si do të ishte?!

Erdhe... Në turmën me njerëz  
mall i brymtë që ecën...  
Më pë... ngrite dorën... dhe queshe.

Po ajo dhimbje burri në zemër:  
ti po vije tek unë

duke dalë prej èndrrës.

## FOKISTI UKË DHE PROMETEU...

Grykë e kaldajës e zjarrtë.  
Fokisti Ukë përtypet,  
ha bukë. Pak  
bukë, pak djathë.

— Bukur, tha ai... si thua ti?  
Ai Prometeu

rrëmbeu

zjarrin prej qiejve,  
ua dhà njerëzve.

— Bukur... gjë e madhe... zjarri.

Kapërdihej e fliste me vete:  
në tëmtha enjtej damari.

- Po është perëndi, tha pastaj mendueshëm.
- Gjysmë...
- Sidoqoftë ka diçka perëndie...

*Në tozra e pluhura qymyri,  
pështetur te muri  
kaldajës hante bukë.*

— *Nuk bën, tha fokisti Ukë, nuk bën...  
Nuk është lehtë të kesh rrashtë perëndie  
në trup.*

*Do të thotë që s'je çoc ndonjë gjë.*

*Do të thotë je vocërrak.*

*Dhe ai, Prometeu, duhet të kuptoj  
kaqe gjë.*

*Si i bëhet t'ia heqim?*

— *Cilën?*

— *Rrashtin e perëndishëm.*

— *Prometeut?! Klitha unë.*

*Po duhet të jetë perëndi!*

*I duhet me Zeusin vetë të përleshet!*

*Fokisti Ukë kapërdihet:*

— *Gjepura! Mjafton i tëri njeri...*

*...dëshmi...*

*Sytë e tij me të mitë ndeshen.*

## ISHTE KOHA KUR STATUJAT KISHIN FRIKË...

Bejlerët e Fierit i digjnin në  
kamina satujat e Apollonisë dhe  
nxirrnin gëlqere për sarajet e  
tyre.

*Ishte koha kur statujat kishin frikë.  
Ishte koha kur statujat tmerroheshin.  
Më mirë atje poshtë  
në terrin e mijëvjeçarëve të ngrirë...  
Të paktën atje një Apollon është një  
Apollon.  
Të paktën atje një Afërditë është një  
Afërditë*

*Ishte koha kur krematoriumet e statujave  
shkrumonin Venerat.  
Në bebëzat tonë kokat e tyre të bukura  
fiksoheshin të vdekura.*

— Le tē ringjallen statujat — feniks në  
këngë!  
Le t'u japë fjala prapë trajtë e shpirt...  
— Do t'i krijojë ato përsëri toka mëmë,  
do tē dalin ato prapë nga thellësitë.

Kënga vetëm mund t'u thotë juve:  
ishte koha e krematoriumeve tē statujave...

## PËR NËNËN TIME...

NËNA, E VOGËLA

LORNAH 2014

Është bërë më e vogël nëna.  
Sikur është ulur më nga toka.  
Më drithërohet zemra:  
e vogël, e vogël...  
Thua të ishte fëmija im,  
nëna:  
Shkon e vjen nëpër odë,  
flet me vete  
e diç kërkon gjithnjë aty te qoshku.  
Gjithnjë diçka ka humbur,  
diçka ka harruar...  
Shkon e vjen nëpër dhomë  
e mua më duket:  
do t'i ngatërrrohet këmba  
në rrezet e diellit  
që hyjnë nga dritarja  
nënës.



— Le tē ringjallen statujat — feniks nē  
këngë!  
Le t'u japë fjala prapë trajtë e shpirt...  
— Do t'i krijojë ato përsëri toka mëmë,  
do tē dalin ato prapë nga thellësitë.

Kënga vetëm mund t'u thotë juve:  
ishte koha e krematoriumeve tē statujave...

## PËR NËNËN TIME...

NËNA, E VOGËLA

: ОИДАИ ГОИ

Eshtë bërë më e vogël nëna.

Sikur eshtë ulur më nga toka.

Më drithërohet zemra:

e vogël, e vogël...

Thua të ishte fëmija im,

nëna:

Shkon e vjen nëpër odë,  
flet me vete

e diç kërkon gjithnjë aty te qoshku.

Gjithnjë diçka ka humbur,  
diçka ka harruar...

Shkon e vjen nëpër dhomë

e mua më duket:

do t'i ngatërrohet këmba

në rrezet e diellit

që hyjnë nga dritarja

nënës.



## MOS HARRO..:

*Nëna, që sapo e shtrova në spital,  
më porosit:  
— Nesër të më sjellësh gjurmashkat,  
gërshërët e thonjve  
dhe gazetën.  
Ah, të keqen nëna! Mos harron  
shaminë e bëllit,  
të zezën...*

## S'MË VIJNË MË LETRA

*S'më vijnë më letra nga nëna.  
Letra ku ajo kërkonte gjithnjë para,  
dhe gjithnjë për pilokarpinë,  
dhe gjithnjë për ipekofarmë.  
Sytë e nënës sime më nuk shohin,  
zemra e nënës sime më nuk rreh.  
Dhe mua tanë në fund të çdo muaji,*

*në xhepin e vogël të pantallonave,  
më mbeten gjithnjë 200 lekë (të vjetër).*

*Ku t'i dërgoj ato?*

#### **DIELLI I VOGËL**

*Sa shpejt u çuan lulet mbi varrin e nënës:  
s'ka hyrë shkurti mirë e vjollca  
e luleshqerra e mbushën tokën plot.  
Eshtë nëna ime,  
si një diell i vogël,  
atje  
poshtë.*

**1984**

திருவாவடையூர் திருமூலர் கோவில்

1960-1961 - 1961-1962

1970-1971

WILHELMUS DE VRIES  
WILHELMUS DE VRIES  
WILHELMUS DE VRIES  
WILHELMUS DE VRIES

三

24

**II. Në  
varrezat  
e dëshmorëve  
në Vlorë**

---

64. 11  
1926. 10.  
enöömdeš e  
šnolV en

5 MAJ.

*Partia vjen,  
si ai prindi, që birin ka këtu  
e gjithë natën e natës nuk e mbyll dot synë.  
Nata kalon nëpër dallgë mendimi,  
nëpër kujtime ku ju hyni — dilni:  
zhveshur, pa ngrënë, zbathur në dëborë:  
Enveri ju prin me mendimet e veta:  
atje ku bini ju — ngrihet liria,  
atje ku bini ju — prapë ngrihetjeta.  
Pastaj shikon ai si vetë historia  
përulet, emrat tuaj merr në duar,  
që ndër gishtérinjt i djegin —  
kalamidhe të nxehta.*

*Partia, si prindi, që birin ka këtu  
e gjithë natën e natës nuk e mbyll dot synë,  
ndër mendimet e veta flet me ju:  
— Atdheu i ri ngrihet... po ndodhka  
kështu:  
vitet shkojnë tutje... e ju vini tëhu.*

## DHIMITËR SALLATA

*Si ta harroj atë ditë?  
E tëra derdhet tek unë:  
një shi i hapur, si pluhuri ujtë janari.  
S'pushoi kurrë, nuk m'u nda.  
Një mërzitje e vjetër, e ndryshkur,  
nëpër llucë të saj — thundrat fashiste...*

*Vdekjen tuaj si mund ta harroj?  
Duart e lidhura tek njëra-tjetra —  
brenda pëllëmbëve, si një zog që dridhej —  
jeta.*

*Ullinjtë e gjorë, krahëkëputur gjer poshtë —  
si mund t'ju mbronin?*

*Vlorën... Vlorën e asaj dite si ta harroj?!  
Shamitë e zeza të nënave, copëra nate  
ulur gjer tek zgripsi i syrit...*

*Rrugina tē varfēra,  
qepenē tē mbyllur dyqanesh,  
si nofulla tē ndryshkura, tē kyçura,  
qindra, mijëra zemra që ishin vetëm  
një zemër.*

*Ti thirre: — Rroftë liria!*

*Zëri yt i gjallë,  
nën atë shi janari.*

*Pastaj: — Mos na harroni!  
Të jeni dashuri e kësaj dite tē madhe,  
e këtij çasti që thërrmohet prej plumbave  
armike;  
tē jeni paqe e bukës suaj.  
Përherë tē jeni kjo thirrje e gjelbër:  
— Rroftë liria!*

*Si ta harroj vdekjen tuaj?  
Eci me të në trup.*

*Si rrymë elektrike përshkon vargun tim.*

*E ndiej  
si gjëmim të përjetshëm të gjakut,  
si këtë zemër  
që tani shtrëngoj fort ndër grushte  
të bindem a është imja?*

*Është imja!*

---

1) Më 11 janar 1943, fashistët italianë morën prej burgut të Vlorës dhe pushkatuan katër shokë. Ata ishin: Dhimitër Sallata, Astrit Kokoshi, Tole Bitri, Palush Kafia.

PANAJOT PAPA...

(peshkatar)

*Jepini së ardhmes  
kafshata prej ditëve të shkuara.  
Le të jenë ato kore të thata, të hidhura.  
Në veshjen shumëngjyrëshe të saj  
qepni copëza  
prej muzgjeve tanë të mugët.*

*Nesër, ajo vetë — e Ardhmja —  
do të kërkojë  
të drejtën e saj mbi kohët e reja që vijnë.*

*Me një buzëqeshje shprese në sy,  
si një firomë agimi —  
supeve hodhëm rrjetën e grisur  
të ditëve...*

*E grisur, e shqyer qejeta  
q'arnonim me duart e çara;  
plagëve rridhte gjaku  
i vjetër i gjyshërve.*

*I kripur edhe ai, porsi deti.*

*E ditët tonë rrëshqisnin  
levrekë nën dritë të hënës:  
një çast na notonin ndër sy,  
pastaj humbnin tutje,*

*zhdukeshin.*

*Rreth zjarrit të natës mbështjellë  
kullonim veç ujë e kripë.  
Dhe dorën e lodhur e shtrinim,  
rrëmbenim kokrrën e qepës.*

*Në sy na lëvrinin si kocet  
mes valëve, të prushta gjithë xixa —  
ditët që dot nuk i kapnim.*

*Aherë mbi vete përthyheshim,  
buzëqeshje e vrërët e jetës, —  
mbi fatin tonë prej njeriu,  
që kurrë nuk e mohuam.*

*Jepini së Ardhmes  
kafshata prej ditëve tona.  
Nesër, ajo vetë — e Ardhmja —  
do të kërkojë  
të drejtën e saj mbi kohët e reja që vijnë.*

## HAJRO ÇAKËRRI...

Të takova në mesin e këngës sime.  
Në një kthesë, në një çip  
të këngës më humbe nga sytë.

Me shapkën e vjetër në kokë,  
xhaketën gri të përdorur,  
xhepat të shqyer nga librat.

Ish zëri yt i hollë e i njirur.

Diçka po u flisje ullinje të Vlorës  
me rrënje nëpër gjak lirie,  
me rrënje sërë — sërë  
eshtra dëshmorësh.

Diçka po i flisje qiellet bubullitës  
të Vlorës. Tejendanë shpalosur  
kuqezi  
si dita e 28 Nëntorit.

*Andej nga bregu i detit,  
ku shfrynte gryk'e Sazanit —  
diçka po i thoshje 20-tës.*

*Evropës i flisje...*

*Çfarë thoshje me zërin e ngjirur  
e xhepat shqyer nga librat —  
tani dhe nga bombat e dorës?*

*U ktheve — në këngën time —  
e more poshtë Muradien, Varoshin,  
Vrenezin<sup>1</sup>)...*

*Mjerimit çfarë po i flisje?*

---

1) Lagje të dikurshme të Vlorës.

*Gurët u udhëve të njihnin,  
kanatat e ngrëna të dyerve hapeshin,  
si vjetmja e vjetër që pret.*

*Njëlloj është fytyrë e mjerimit.  
Dhe sytë e thellë, të menduar,  
dhe gjaku i prishur, bërë ujë  
i të varfërve — lirinë ushqen.*

*Lirisë që po lindte prej gjakut tënd —  
me fjalë t'ullirta të Vlorës,  
kujeta është shqiptare  
dhe vdekja shqiptare është, —  
ti çfarë i thoshje?*

*Në mesin e këngës sime  
vdekjen tënde takove:  
— Oh, Hajro, thuamë: vdekjes ti çfarë i the?*

*U patë në cep të syrit...  
Pastaj ti buzëqeshe —  
dhe vdekja u drodh porsi nata  
shpuar prej rrezes së parë  
të diellit.*

*Përjashta te dera e shtëpisë,  
veshur gjithë në të zeza,  
krahët lidhur në gjoks,  
Dedeja<sup>1)</sup> të pret,  
të pret...*

*Ashtu presin nënët.*

---

1) Nëna e Hajros

## KUJTIM HOXHA...

*U ula në bankën e shkollës,  
por vendi pranë qe i zbrazët —  
nuk ishe ti.*

*Dy sytë e gjelbër kërkova,  
me sytë e mi t'u thoshja,  
t'u flisja diçka — por nuk ishe ti:*

*Mbi shishen e vogël të bojës  
u shfaqën dy duar fëmije —  
oh, nuk ishin të tuat!*

*Një dhimbje e egër më çau përbrenda,  
sikur rrufeja çan lisin  
janarit mbi Qafë të Shëngjergjit<sup>1</sup>).*

---

1) Në Operacionin e madh të Dimrit 1944, një skuadër partizane gau rrëthimin nazist në Qafë të Shëngjergjit. Atje mbetën dëshmorët Kujtim Hoxha, Lilo Asllani e Hazbi Mete.

*Aherë ju pashë se si ecnit  
brenda vetë fjalës liri.*

*Ju shkonit gjithë zhurmë, thërrisnit,  
një këngë partizane përgjakej  
përbrenda fjalës liri.  
Thërrisnit, kërkonit shoshoqin,  
tërhiqnit shokun e vrarë,  
e hidhni mbi supe të ngrirë — dhe ecnit,  
dhe ecnit, dhe ecnit... vetë brenda fjalës  
liri. —*

*Dikush  
thirri: — Shokë!... U kthyet sërisht  
me frymën tuaj të paktë  
të ngrohnit firomën e fundit të tij:  
«Lamtumirë!».*

*Si majë e errët e shpatës,  
herë dukej herë zhdukej në qiell,  
Qafa e ngrirë e Shëngjergjit:  
«Lamtumirë!»*

*«Lamtumirë!»*

*«Lamtumirë!»*

*Stuhija përplasej grykave —  
s'kish shpirtin e saj, por tuajin.*

GOGO MATI...

U ktheva në Vlorë.  
M'u rënduan supet nën shira dhjetori.  
Shkel i vetëm asfalteve.  
Përse kjo gjethe e lagur portokalli  
më lëkundet në sy?  
Qyteti im... e këtu më nuk më njohin.  
I madh, si një qiel i habitur,  
bie mbi mua syri i kësaj vajze,  
që më shkon pranë. Vlora...  
Kurse unë dëgjoj zëra të njohur, të njohur.  
Dikush po më thërret... kush?  
Zëra vitesh... po kush?  
Zëra luftërash... po kush të jetë,  
kush?  
Zemra ime ecën përpala, ngutet.  
I bie pas: dhe dhimbje dhe mall. Vlora...

*Ngjita shkallët e gurta, të bardha.  
Varrezat e dëshmorëve. Shokët.  
Ç'sy të thellë, të menduar — si një qiel  
oqean që shikon mbi veten e vet — këtu Liria!*

## ...ITAM OOOO

Mbi pllakë të mermertë, përkulur si nëna,  
ulliri...

Cili shok, cili thëngjill lirie, këtu po më flet?  
Ndaloj hapin... Lehtas ngre tufën e gjelbër

— Oh, Gooo Mati!

NÖNA

1.

*Shamia e zeze  
dhe sharpi i zi;  
dy herë binte nata mbi kryet e thinjur.*

Ke negara E negara muda, a kudu akur  
E ungel, e ngari nana, a thua sikur  
isoni bete ente merdekuur ma gusut  
kontu bete ente merdekuur ke guduk  
dhe ecen mbi toke.

Vete e vjen nëpër odë — Me gjurmëzat e  
lehta shkel oborrin,  
rrëmih trëndafilin e bardhë,  
E vogël, e vogël ajo — një grusht kohë,  
flet me vete,  
tund kokën.

2.

*Atë e kërkonin lugjeve, pllajave.  
Atë e kërkonin pyjeve, majave.*

*Nëna priste: nëpër mendime,  
nëpër liqene gjumi e ëndrrash  
takonte të birin...*

*Po përsëri agimi zgjohej  
me po ato fjalë në buzë:  
— Sot, ndofta e gjejnë...*

*Do ta gjejnë, patjetër!*

*Dhe ndiente se me zërin e saj  
dikush pëshpériste pas:*

*«Do ta gjejmë tët bir...»*

*Kthente kryet —  
nuk kishte njeri!*

3.

*Ku kishte rënë luftëtar i lirisë,  
dy gisht varr a i kishte?  
Lufta e Dytë si një natë pis  
shkonte mbi botë.*

*gremisej.*

*Kur nata dhe krimi mes krimeve ecte,  
dhe çizmet përgjaknin  
dhe barin  
dhe bukën,  
dhejeta ndër pellgje rënkimesh të egra  
kridhej e ngekte —  
si qindra e mijëra të tjerë,  
si erë që ndodhet kudo:  
ai  
gjakun lirisë ia jepte —  
dhe bëhej liri si ajo.*

4.

*Tokë! Një herë njerkë, dy herë nënë!  
Ti, pjalm dashurie,  
dhimbje e rëndë.  
Oh, toka jonë e dashur:  
tri herë më e dashur me vdekjen tonë  
përzier!  
Vijmë tek ty, në trupin tënd hyjmë  
me jetën tonë prej rrënje  
qiparizi,  
ulliri,  
dafine —  
me jetën tonë gonxhe trëndafili  
të porsaçelur në zemër —  
dhe dheu yt që mos na lëndojet,  
merr formën e kurmit tonë.*

5.

*Atë e kërkonin lugjeve, pllajave.  
Atë e kërkonin pyjeve, majave.  
Dhe një mbasdite, në themelin e ri,  
dikush, përnjëherësh thirri:*

— Eshtë ky!

*...Dhe nëna ndjeu së largu  
çapin e tij që gjëmoi.  
Shikimi i saj akulloi te pragu,  
vetë zbrazëtirën e shoi:*

*Ajo mezi foli: — Tiii:::?!  
Ajo vetäm tha: — Po nga u vonove kaq  
shumë?  
— Ja, erdha... — buzëqeshi ai.  
— Po, erdhe... — tha ajo më në fund.*

6.

Prehjet diellore tē birit,  
peshën prej drite tē tij,  
tek mori nē duar  
mund ta peshonte  
vetëm zemra,  
frymëmarrja e prerë e nënës.

Arkëza e lehtë, e lehtë...  
Koha e dheu kishin punuar —  
mbi djalin e saj  
apo mbi një tjetër?

Dhe nëna nguli shikimin mbi arkëz  
edhe iu bë sikur përnjëherësh  
germat e emrit tē birit lëvizën —  
si atëherë kur ishte fëmijë  
dhe me dorën e njomë  
me ato shkronja sajonte ai  
fjalën Liri,  
fjalën Njeri.

Dhe ndjeu gjakun në trup që i shkriu:  
dhimbja e gëzimi klithën përbrenda,  
se në fund tē fundit ishte njeriu,  
se në fund tē fundit qe nëna!

Bir i një nëne ish dhe ai,  
i luftës së shenjtë të njerëzve të thjeshtë.  
Trupin në plumba,  
dhe ai e kishte,  
ai  
që heshtur fliste  
me ditën e re,  
me ty,  
me mua,  
me jetën e vdekjen — mbyllur në arkëz...

Se dhe ai diku kishte rënë,  
nën pisk të diellit, natës pa hënë.

Lirisë që po lindte prej gjakut të zemrës  
në çastet e fundit, si vashës së shtrenjtë,  
ashtu të përgjakura  
dy fjalë ia kish thënë.

7.

Nëna e jetës — nëna e lirive;  
ajo e thjeshta — nëna e të gjithëve;  
ajo e përhershëmja — nëna e fëmijëve,  
nëna e popujve dhe e historisë!

*Vetes i tha: — Ky qe fati im,  
shorti i nënës që në jetë më ra.  
Vetes i tha: — Ky është im bir,  
dhe djali nënën ja ku e ka...*

*Dita e bardhë.*

*Ajo në të zeza  
përkulur pakëz nga toka,  
ashtu si avllinë vetë shekullin presin,  
gjurmët e saj të vogla.  
Atje në varreza,  
ku shokët e rënë të flenë nuk dinë,  
ajo, e pagjuma,  
përkulur si vetë fjala nënë,  
qëndron*

*përjetë*

*mbi të birin.*

Dicas e dicas

Há dias de humor

que só se vêem

desde que o mundo

desceu da montanha

que só se vêem

desde que o mundo

desceu da montanha

que só se vêem

desde que o mundo

desceu da montanha

que só se vêem

desde que o mundo

desceu da montanha

que só se vêem

desde que o mundo

desceu da montanha

que só se vêem

desde que o mundo

desceu da montanha

que só se vêem

desde que o mundo

desceu da montanha

que só se vêem

desde que o mundo

desceu da montanha

que só se vêem

# **III. Pulëbardha e ngjeshi gjurmën...**

---

গুরুবাবুর পু  
স্তি সে  
...পঞ্চাশ

## P A T J E T Ë R . . .

Në çastin që ti erdhe tek unë,  
patjetër diçka e madhe, njerëzore,  
diçka universale  
duhet të ketë ndodhur diku.  
Një fëmijë do të ketë folur  
fjalën e parë në jetë...

Patjetër. Patjetër.

# PULËBARDHA E NGJESHI GJURMËN

...si vijnë e shtrihen e hapen  
valët e detit, buzë agimit të ditës;  
si derdhet mbi to — nga malet e Vetëtimës —  
përflakja e diellit: tymon e nuk shuhet...  
Për nder! Tani pulëbardha e ngjeshi gjurmën  
mbi zërat e bardhë të kaltërsive  
e saj  
shkumbuese.  
Për nder! Tani poezia vetë rrrokjezon  
nëpër gjurmët e zogut,  
si nëpër kohë mermeri  
fjalët etruske.

## E NJOH ECJEN TËNDE

*E njoh ecjen tënde që godet tek unë  
si e rrahura e zemrës.*

*Jam burri që mati kohën e vet,  
jo me tiktakun e kësaj ore mesnate,  
po me hapin e lehtë të këmbëve të tua.  
Vetëm ato mund të gjejnë shtigjet*

*e parrahura  
të mendimeve të mia prej vjeshte  
tani.*

*Balta, era, ngrica ku ti shkel  
bëhen prej qielli.*

*Eshtë e habitshme  
si çelën narcizat e gjurmëve të tua  
në ëndrrën e mbrëmshme  
për ty.*

## ME TY UNË PRAPË JAM MALL. . .

*Me ty unë prapë jam mall.  
Pa ty unë prapë jam hall.  
Mesnatë. Syri zgjuar...  
Pagjumësia jam.*

*Në shpirt një dhimbje e bardhë.  
Në shpirt një lot pastaj.  
Nga dhimbja e gëzimit — për ty edhe  
se si më vjen të qaj. për mua —*

*Ti në mesnatën time  
një zjarr i bukur je.  
Dhe unë duart i shtrij drejt teje si fëmija  
që zjarrin nuk e njeh.*

## NË SHTËPINË E VJETËR

Në strehë të zërit të dëhimbshëm të gjyshes —  
çerdhja e vjetër.

Në fijet e brinjëve të mia,  
u ul dallëndyshja.  
Një cicërimë e kaltër spërkati qiellin.

Vlorë, 21 mars 1984

## SHKËMBI I VAJES...

*Dilni prej legjendave, motrat e mia.  
Eshtë akullirë,  
është rrëqethëse zemra e gurit.*

*Dilni prej baladave, të dhembshurat e mia.*

*Eshtë tmerrësisht kapitëse  
udha që të çon në zemrën e një balade.  
Dhe mua më duhet të përshkoj tunele  
shekujsh të mugët,  
me një dritë pishe në dorë.*

*Gjaku juaj është filli i Arianës  
që humbet rruginave të errëta  
të tragjedive të verbëta.*

*Gjaku juaj filli i Arianës...*

I) Legjenda thotë se 90 vajza krutane, që të mos bimin në dorë të osmanëve duke vallëzuar u hodhën poshtë në humnerë. Qysh atëherë vendi u quajt «Shkëmbi i Vajës...».

*Ku e këput ai? Edhe pisha m'u shua..  
Tani, nga larg, nëpër hamendësi  
ndjell murmurimën e zérave tuaj:  
një këngë...  
një thirrje...  
një vaj...*

*Eshtë bijë e një dhimbjeje të thershme  
legjenda.  
Dhe krahët tuaj të lehtë e të bardhë  
janë rrënëjë guri, që krisin e çajnë baladat —  
e çohen drejt qiellit  
me rruzullin e diellit të lozin.*

*Eshtë klithmë e një dhimbjeje të egër  
legjenda,  
britmë kohërash që s'duan të humbin në  
veten e tyre:  
dhe ju, bërthamë diellore  
ngujuar në to.*

*Unë i çmurosa baladat tmerrësisht të rënda.*

*Dilni prej legjendave, të dhembshurat e mia.*

*Shkelni me çapin e shkathët mbi barin e blertë.*

*Përthyeni gjurin e bukur  
dhe shtroni pecetën e bardhë mbi tokën e ngrohtë.*

*Vëruni bukën përpara vëllezërve.*

*Syri ynë u bë i menduar: na u rritën  
motrat...*

*Cili do të jetë fati i tyre?*

## UNË NUK E DUA AKILIN...

*Unë nuk e dua Akilin.*

*Si një kërcënim gjëmues, i madhërishëm e  
fatal,*

*këmbët me flatra — ai hyn' e del  
nëpër agoninë e bardhë të Trojës.*

*Më dhimbset Teti, eëma,  
perëndesha: Tetida e detit tim.*

*Por, unë nuk e dua Akilin,  
akërimin e tij bubullitës —  
dhe vetë jam Hektor,  
kur para dyerve Skeé  
ushta mizore ngulet në parzmën time —  
njerëzimit të gjelbër  
unë i lë tri fjalë të përgjakura:  
Atdhé... Liri... më ftohet ndër buzë:  
Andromakë...*

## K O R B I ...

... një korb  
plak e i lodhur, mëngjes për mëngjes  
vjen këtu tek parmaku ynë. Krroket...

Krroket...

Krroket gjersa unë të hap dritaren  
e duke folur me të  
i hedh kafshata të buta buke.  
Ai i rrëmbej ndër çaponj, i sqepon...  
Po gruaja ime e ndjek, e përzë.  
Ka frikë gruaja nga krrokitjet e korbit.  
Kurse shpendi ka sy aq të mençëm, aq të  
urtë:  
e njeh dorën që hap dritaren,  
zërin që i flet:  
dhe më sheh ndër sy, i gjori plak.

## KULLOJ VJESHTË I TËRI ...

*Sytë e tu dy liqenë të menduar qiellosrë.  
Nuk e di se nga erdhi  
pelikani i vetmuar  
dhe u ul mbi valë.  
Cep i krahut të tij  
më spërkati të tërin:  
tani derdhet mbi mua  
kjo breshëri stërkalash  
të kripura  
si lotët.*

*Kulloj vjeshtë i tëri.*

## ËSHTË NJË TJETËR...

*Ti kujtohesh për mua kur je e gëzuar,  
ti do që gëzimin ta ndajmë bashkë.  
Dhe unë me ty, — po ç'të bëj unë me ty? —  
këtu fol e qesh... atje buzagaz...*

*Por është një tjetër — Ah, është një tjetër! —  
që më do mua — Oh, më do mua! —  
dhe kur ësht' vetëm, dhe kur s'ësht' vetëm,  
më kërkon në takim, në ndarjen e rëndë;  
më kërkon në mëndje,  
më kërkon në zemër...*

*Dhe zemra e saj në gjoksin tim dhemb.*

## DHE ISHTE NJË LODËR...

*Në breg të detit po lozja me mallin tënd.*

*Në pëllëmbë të dorës dhe qelli dhe deti.*

*Në pafundësi humbte horizonti.*

*Atje e ngula shikimin: një pikëz... një pikëz...  
një pikëz...*

*Prej paskajësie*

*kokrrizë ere, kokrrizë dielli,  
stërkalë e shndritshme që ecte,  
zog i bardhë malli që lindte papritur —  
drejt meje po vije ti...*

*Triumf, brohori kaltërsie.*

*Dhe ishe një lodër.*

## KU M'I ÇON SHIU TRISHTIMET?

*Ku po m'i çon shiu trishtimet?*

*Ky shpirt tectori që po endet  
kërkon një zemër ku të hyjë.  
Ti mos i mbyll sytë e mëdhenj,  
ti mos m'i mbyll dyert e zemrës:  
në zemrën tënde unë kam hyrë  
si ylli që u ndez në qiell  
përpara  
se të ngryset dita...*

*Ku po m'i çon shiu trishtimet?*

## BARIUT 18-V JEÇAR NGA TARAZHI

Më jep atë natën tēnde tē 22 shkurtit — pēr tē cilēn më flisje lart nē Fushēlugje — kur malet rrotulloheshin rreth teje si shpirtra tē egér.

Më jep ato ditē e net tē tua pa gjumē, qē endeshin sa andej-kēndej nē kasollen e vogël -  
dhe flinin nē kēmbē...

Ah, nem at natë, kur mes errēsirës sē vērbēr, kishe pēr udhērrēfyese vetēm blegērimat e bardha.

Gjēmimet e qiellit ta shuanin kandilin  
dhe ti mbaheshe nē gjumin tēnd  
qē tē mos bije.

Nēpēr kēmbē, befas shfaqeshin,  
si liqene tē bardha blegērimat —  
pērshēndetnin jetēn.

Ti i merrje ndēr duar:

*shihje syrin kalesh të qengjit që kullonte ujë  
dhe mishin e ngrohtë, të dridhshëm ia vije  
nënës te kryet —*

*ta njihte gjakun e vet.<sup>1)</sup>*

*Të mos e neveriste nëna pjellën e saj.*

*Të mos e neveristejeta të ardhmen e saj.*

*Ah, nem atë natë bariu, djalosh i ri,  
ti më mësove se si të mbahem nëpër gjumin  
tim.*

*Dhe te kryet e kohës sonë  
të vë këngët e mia të bardha,  
se janë pjella e saj,  
gjaku i saj.*

*Ajo, koha-nënë, të mos i neveritë  
kurre!*

1) Sapo lind qengji, ia vënë nënës te kryet që t'i marrë erë dhe ta njohë, se ndryshe ajo nuk e pranon më pastaj.

## PËRSE PASKAM FRIKË T'I AFROHEM DETIT?

*Përse paskam frikë t'i afrohem detit?  
Ka q kohë pa e parë... Ka q kohë pa u parë...  
Unë e Joni... rritur me njëri-tjetrin...  
Së largu më mbështjellin zëra të njojur,  
gjëmimi i përmallshëm, hutues i detit.  
Po si kthehem unë?  
A jam ai diellori,  
ajo haré fluturimi e zogut të qiellit,  
ai çast i dhimbjes së kristaltë  
të shkëputjes së stërkalës —  
ai mendim universal deti?!*

*Përse paskam frikë t'i afrohem detit...*

## ADMIRAGJETTA SYTË E TU...

Erdhi dallëndyshja e parë në sytë e tu.  
Solli qiejt e parë, ligjërimet e para...  
Fluturon e s'di ku të ndalet, —  
kërkon folenë e saj...

E ka në zemrën time.



Eshtë Joni dhe Adriatiku aty-nëpër sytë  
e tu...  
Dhe Llogoraja është, dhe fëmijëria ime,  
në lodër qiellore  
yjet e mëdhenj një nga një i ndez  
përmbi Akrokeraunet e jetës.

Eshtë dashuria ime aty — nëpër sytë e tu...

Ku duhet të jetë tjetër?!



Në qiellin e prillit të syve të tu,  
me dorë, hodha zogjtë e dallëndyshes...  
Le të mësojnë të fluturojnë aty!

## TË KAM TAKUAR NË TË ARDHMEN TIME . . .

*Të kam takuar në të ardhmen time.  
Nëpër rropama të së ardhmes të kam  
krijuar.  
E dashura ime! - i ngjaja gjëmimit të dritës,  
që ecën vetëm përpara  
e s'kthehet dot pas.*

**1979**

## TE GRYKATE AKERONTIT NË BISTRICË

Duke zbritur në botën e nëndheshme,  
nëpër rrugina të territ paskaj,  
mbaj në dorë — kandile të ndezur —  
emrin e saj...

## SHIFRËN TËNDE XX E VARA NË VARËSEN E DERËS...

*Shekulli im,  
shifrën tënde XX e vara në varësen e derës.  
Dhe pezull qëndrova mbi fatet e popujve:  
ikte një dallgë e vinte një dallgë,  
si vijnë e ikin krizat, p.sh.  
si vijnë e ikin luftërat, p.sh.  
divisionet e ushtarëve,  
kilometrat e fronteve.  
Me ç'masë matet gjaku i të vrarëve?  
Ku varrosen varrezat e kohëve?  
Ne fushat e ngrira të tyre lëronim  
e hidhnim farë —  
në tokë mbinte hekur;  
ne hidhnim grurë —  
mbinin të vdekur...*

*Dhe mua më dukej sikur  
gjithë rrënjet e tragjedive të tua  
ushqeheshin tek unë.*

*Shifrën tënde XX e vara në varësen e derës.*

## NXËNËSIT E FSHATIT PRISKË VIZITOJNË SALLAT E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE

*Ejani, zogj të qiellit e të erës,  
diej të vegjël të maleve,  
që rrokulliseni zhurmëplotë  
qytetit të madh!*

*Sapo ju vutë këmbën te pragu,  
dhe raftet u drodhën, librat u hapën.*

*Këtu janë shekujt, epokat, kohërat...  
(Fjalë të mëdha, apo jo?!).  
Lindin, jetojnë e pastaj  
edhe ato vdesin.  
Dhe vijnë e ngjiten këtu  
rradhiten bri njëra-tjetrës.*

*Këtu — në këtë fjalor — është fjala bukë.  
Që kur lindi e gjer më sot,  
në buzë të çdo njeriu, të çdo populli,  
thëngjilli i parë  
që ndez zjarrin në vatër.*

*Shekuj tē tērē kanē qenē skllevēr tē bukēs.  
Prindērit tuaj dhe ju - jeni çlirimtarë tē  
bukēs.*

*Këtu janē shtetet, që nga ata mē tē  
veckēlit,  
që lëvrijnë si larva nē trupin e historisë, —  
e gjer tē supershtetet e përbindshme,  
këta brontozaurë e megatoriume tē shek.*

**XX.**

*Këtu janē çezarët (nuk dua  
as t'i përmend emrat e tyre!),  
me «ç» tē vogël: çezarët...  
Jua lë juve — nëse meritojnë —  
shkruani po deshët me «ç» tē madhe: Kajus  
Julius Çezar!  
Unë vetë nis e mbaroj këtu - te «ç» e vogël.*

*Këtu është Homeri, Dantja, Shekspiri.  
I pari, i verbër tërë jetën.  
Kripërat e lotëve, edhe tani  
gërryejnë zgavrat e syve ku Troja vdes.  
I dyti qan për dashurinë e vdekur,  
por edhe nëurrejtjen e tij tē gjallë,  
prapë ai qan... I treti,*

*Këtu janë katrëgjyshërit, stërgjyshërit,  
gjyshërit tuaj...  
(— Ku janë? — pyesni ju. — Ku i kanë  
emrat?!).*

*Aty do t'i gjeni të parët tuaj,  
ata më trimat dhe më heroikët.  
Ejani, diej të vegjël të maleve!  
Kandila qiellorë: pak dritë,  
dhe në duart tuaja; fletëzat e zemrave të  
me rektime gëzimi hapan —  
epokave  
si lulet.*

## VAJZA ME PORTOKALLE

(31 dhjetor 1987)

*Po ti ku i gjete, ku i këpute,  
këta diej të vegjël të gëzuar të Jugut?*

*Sonte dashuritë nuk rrinë dot vetëm  
thërrasin në emër dashuritë njëra-tjetrën.  
Edhe vëtmia ngado që të jetë  
ngrihet e shkon te shoku i vet.*

*U ngula në udhë,  
si ky bredh i gjelbër. —*

*Ndizi tek unë  
diejt e vegjël.*

## ÊSHTË AJO DASHURIA...

*Eshtë ajo dashuria...*

## NË KORÇË, PA TY...

Eshtë një ditë e shkëlqyer në Korçë,  
një diell i madh, i tejdukshëm  
më përshkon tejendanë.

Nëpër rrugë shesin karafila të kuq:  
10 qindarka një...

Eshtë një ditë — leshraverdhë korçare,  
kraharorëhapur, gjithë erëza vjeshte.  
Midis gjinjve — karafilë të kuq:  
10 qindarka një...  
Uh, quell! Po si u duruaka kjo ditë,  
kur karafilat e Korçës gjithandej  
kundërmojnë këtë mall gërryes për ty...

## PËRSE E TRISHTON DASHURINË?

*Përse e trishton këtë dritëz  
që bie mbi asfaltin e natës dhe ecën  
para meje?*

*Ku të gjej, ku je?*

*Si zëri i trembur i një fëmije  
rrezja e dritës po të kërkon.*

*Kurse ti...*

*Ti do të më tregosh  
se mund të bësh edhe pa mua.*

*Eh, mirë, pra! Zogu i zemrës sime  
brofi prej çerdhes së vet:  
nëpër natë u lëshua fluturim,  
por s'ka ajër nën krahë... nuk ka dritë.*

*Ti, sa e marrë që je!*

*Përse e trishton dashurinë?*

## BESIM NË NJERIUN

— një kritiku —

Vërtet, nuk trishtoheni ju  
kur shihni tani këtë qìell tetori  
që lodron në detin e vesës  
të këtij trëndafili të bardhë? Në zemrën  
e trëndafilit dallgëzohet oqeani qìellor  
dhe çdo fletë hapet  
si krahët e një pulëbardhe, që me sqepin e  
saj,  
nëpër vijëza vetëtimash shkruan në qìell:  
«Dashuria e parë...».

... Vërtet, këtë çast,  
zemra juaj a nuk ka qëndruar në grushtin  
e saj  
si një zog që dridhet:  
një dhimbje, një mall i bardhë, një pjalm  
ju mbështjell të tèrin, si bryma  
mbështjell ullirin e gjelbër të janarit?

*Shikoni: mbi antenën e televizorit  
dy pëllumba po puthen sqep më sqep —  
lodrojnë me krahët e puthen.*

*Nën këmbët e tyre, nëpër trup antenash,  
grinden radiostacionet, kontinentet,  
shtetet, gjuhët e botës grinden, —  
thua sikur janë hijena: Regani, Golfi*

*Persik;*

*rënie e dollarit, raketat pershing, shpërthime  
bërthamore...*

*Pëllumbat shkrihen me krahië të hapur,  
gushohen, marrin frymë në fryshtim e tjetrit.  
Dhe unë ndiej një fryshtim të thellë  
dhe thërras i ngazëlluar: jeta është  
e pavdekshme!  
Njeriu i lirë do të fitojë!*

*Po ju më thoni: hiqe fjalën dhimbje! Përse?  
Nuk shihni se mbi kokat tuaja, te këndi  
i murit, dikush apo ngjiti këtë nekrologji: «Sot...  
vdiq nëna jonë...»  
Një nënë ka vdekur — si nënët që vdesin.*

*Ju, çfarë? Vërtet nuk ndieni në zemër një  
dhembje?*

*Asgjë s'lëviz tek ju, asnë fletë zemre nuk  
dridhet?*

*Nuk ju besoj! Dhe sikur të jetë e vërtetë,  
përsëri s'do ta besoja kurrë!*

*Se kjo, kjo po... që do të ishte  
vdekja ime më e neveritshme.*

*Unë ndiej  
një trishtim e mall diellor, —  
pa të cilinjeta s'është jetë,  
dashuria s'është dashuri.*

*Pa të zemra e poetit është vetëm një zgavër  
e vjetër, arkaike dhe e frikshme.*

*Por ju grindeni vetëm sa sytë tuaj  
bien mbi fjälën trishtim në vend  
që të shihni në të, si në rontgen,  
fletët e mushkërive të gjelbra  
të besimit tim në njeriun.*

## GRUA, LERMË TË LUAJ ME GURALECËT ..

Grua, lermë të luaj me guralecët, grua,  
i paskam harruar goglat e ajërtatë  
qiparizave,  
gështenjat e egra  
që bien asfaltevë si prushe vatre —  
lermë t'i hedh nëpër duar,  
të më përvëlojnë gishtërinjtë...  
Le të shikojnë qesëndisës kalimtarët:  
si hy unë nëpër sytë e tyre?  
Poeti... Ah, poeti! Oh, poeti!  
Grua, ti bën mirë: në tryezën e punës,  
aty nga ora 10<sup>30</sup> sillëm gotën e ujit  
dhe dy aspirinat:  
nis dhimbja e kokës, migrena,  
ezaurimenti apo tensioni i syrit?  
Po tani lermë ta kap në ajër  
gjethen e bronztë të rravit,  
dorën e hapur të vjeshtës.  
Nëpër gishtërinjt' e saj të shoh ty...  
Unë kam jetuar pak,  
fare pak:

*jeta ime éshtë e tëra brenda një vargu!  
Atje kam pritur lindjen e ditëve të mia,  
atje kam pritur mbrëmjet e tyre,  
atje kam vdekur dhjetëra herë,  
dhjetëra herë kam lindur —  
brenda një vargu. Muza...  
E kam dashruar atë gjér në harrim!  
Dhe prej harrimit tim kam ngritur  
përmendoren e fullimtë të saj.  
Sa herë brenda një vargu  
ngrita mbi supe funeralet e muzës sime:  
ishin të rënda,  
kapitëse. Grua — sa mirë! — ashtu  
me pakëz alkol fërkomë supet,  
kanë ngrirë nën peshën e rëndë  
të vdekjes së muzës. Apo, ndofta,  
spondeloartroza...*

*Por unë dola prej vargut dhe tanë  
po loz me cingla me këta çamarrokë —  
me fëmijërinë time, desha të them:  
në mesin e udhës*

*i shtyp majën e hundës: — Uuuh, qurrashë!  
Dhe për ty më ardhka kështu për të qarë?  
Dhe ti më nxjerrke kështu gjuhën,  
këtu në mes të trajektoreve qiellore?  
Përqeshet me mua jeta ime, ky shekulli im  
tragjik,  
që e desha aq shumë,  
që aq shumë më deshi!  
Grua, c'më solle tani valiumin?!  
Nuk e sheh: si një fëmijë,  
unë po loz me këto lule të pafajshme:  
dallgëzon deti i vesës së tyre  
dhe dielli — më fëmijë se unë! —  
po çmendet prej gëzimit  
në qiellin e zemrave të narciseve të Vlorës.*

*e këlhet.*

*Dhe rreh qielin me cipalet  
e krahëve të thatë.*

*Mos u tremb. —*

*S'e ka me ty,  
me mua e ka!*

*Ti...*

*Ç'do t'i bëje ti lundrës së tij të stërmocme?*

*I lehtë, si shpirt drite,  
ti je murmurimë e valës*

*që na rrjedh nëpër gishtérinjt' e kujtimit.*

*Tani shikimi yt është vetëm prej malli,  
buzëqeshja jote vetëm prej trishtimi.*

*Tani*

*duart e tua të njoma*

*janë vetëm kuptimi i dy gjetheve hardhie*

*që lozin në ajër mbi né —*

*e nuk i shohim dot.*

*Ti...*

*Ç'do t'i bëje ti lundrës së tij të stërkalbur?*

*Ti je vetëm lodhja*

*e fluturimit të krahëve të zogut të qielilit.*

*Diku ai do të ulet... diku do të çlodhet.*

*Le të pushojë mbi degën e zezë të vetëtimave*

*që dogjën qiellin e dhimbjes sonë pér ty.*

*Ti je vetém frymë, shpirt agu agimi.*

*Dhe je èndërr...*

*Ti ke vetém peshën e shenjtë  
të èndrrës sonë prej fëmije.*

*Mos ki frikë prej atij thinjari gërnjar!*

*Unë mund të të përshkoj ty*

*nëpër bedenat e dhëmbëdhëmballëve të tij  
të rëna.*

*Vetë, kaq herë, kam hyrë e dalë nëpër to.*

*Po ti paske qenë vërtet një trim i pashoq,  
vogëlushi im!*

*Ti gënjeve vetë vdekjen:*

*ajo pandehu*

*se tek ti do të ngrinte*

*lumenjt' e pashtershëm të gjakut tonë.*

*Në këngëgjëmimin e përjetshëm të gjakut  
do të akullonte natën e saj të egër.*

*Kështu, pandehu ajo, vdekja...*

*Kur ti ishe vetém një thirrje: Lumi!*

*Vetém një mirupafshim: Lumi!*

*Vetém një lamtumirë: Lumi!*

*Atje ku flë ti,  
që të rëndojë sa më pak,*

*toka harron dhimbjet e saj.  
Dhe bëhet e lehtë e lehtë...  
Nata e pret frymëmarrjen  
dhe duke shkelur mbi rektime të thella;  
mbi majë gishtërinjsh  
përçik dheun.*

*Sepse ti vërtet  
kishe qenë një trim i pashoq, vogëlushi im.*

*Dhe tani dëgjo mirë, mba mend se ç'të them:  
tani  
midis buzëve merr këtë gjethëz ulliri.  
Kur të marrë malli,  
Kur të na marrë malli,  
lëndoje pakëz me dhëmbëzit e vegjël...  
I athtë dhe i hidhur,  
përzier me ujërat e qiellit  
dhe ujërat e detit të Vlorës —  
lëngu i gjelbër derdhet në gojë...*

*Dhe ti këlhehesh sërisht tek ne.  
Mos harro: mjafton ta lëndosh, Lum trimi,  
sa të na dhembti pakëz... thëllë...  
Dhe ne jemi prapë, jemi prapë bashkë!*

*Ndërsa Karonti i mbrapshtë  
nuk e ka me ty —  
me mua e ka:  
se unë jam i rëndë, i rëndë...*

*Unë jam ngashërimi i fundit,  
akoma i pashkëputur  
nga zemra e nënës për ty:*

*dhe mund ta përmbyss barkën e tij!*

## ROMEO XHULJETA NË SHPELLËN E GADIMES

*Po si më dolët përpara këtu,  
ju të dhemshurit, ju të mirët!  
Fare papritur si m'u shfaqët kështu  
në zemër mermeri të ngrirë?  
Me dorë që dridhet cilën të prek:  
përlindjen e dashurisë së njomë,  
apo trupin e dashurisë vetë?*

*Oh, zemër, shpirt i tokës... Romeo-Xhuljetë.*

*Dashuria ime,  
që ngjall vdekjen vetë.*

*Me dorën që dridhet  
frymëmarrje tragjedish të mermerta po prek  
... Romeo-Xhuljetë.*

*Dhe iki...  
pas hapave të mi era flet:  
Oh, Xhuljetë...*

## NË TROJË...

*Shullëhet në diell hardhuca.  
Akrepı dykokësh gudulis  
bishtin e vet — a do ta kafshojë?  
Deti ka ikur gjér tutje  
e ndër leshterikë merimanga end  
rrjetën e ajërtë të ditës,  
të grisur nga zërat e erës.*

*I ri, i fuqishëm  
kali i drunjëtë.*

*S'trokon. Nuk ecën.*

*Po ngjiten atjé  
të bardhë me lëkurë të lbyrur,  
zezakë, verdhushë me sy picigjatë,  
turistë me sandale,  
turiste me nallane —*

përzihet djersë e athtë e deodoranti,  
zbathur, me çizme —  
rëndë-rëndë, si në një lojë  
shekulli im ngutet  
të hyjë në barkun e kalit.

E kali n'erë hingëlluese  
s'trokon. Nuk ecën.

Kur shekujt prapazi hiqen-si gërrthjet.

Po zbresin: Agamemnoni  
thyen ca rrokje në gojë  
dhe i hipën veturës bojëhiri;  
Andromaka nën sqetullë shtrëngon çantën  
e vogël,  
brenda ka rrasur dy copë sanduiçë,  
ndez një cigare e mbahet mendueshëm  
në krahun e Patroklit, që fare s'e njeh.  
Paridi zezak, trupajthëm,  
krenarë sheh diellin që lind  
mu mbi kokën tullace t'Ulisit —  
e ky e mbulon me kapën sportive  
dhe ndien një uri ujku ndër zorrë.  
Akili, imcak e kockëlehtë  
— nga ishujt e Pacifikut? —  
kopsit 10 dollarëshin në xhep të bluxhinsit.

*Priami e Hekuba, pérherë pleq,  
gjithë kohës shtrëngohen tek njëri-tjetri  
dhe ndiejnë ethe të ftohta Irlande në trup.  
Menelau, vërtetë Menelá:  
në sy e varros Helenën  
që sapo e takoi  
në barkun e kalit të drunjte.  
Shih, Andromakën: me pjatën e supës  
përpara,  
me gishtërinjt' e vegjël po fshin  
të vetmin lot që i këputet prej syrit:  
  
nuk do ta kujtojë Hektorin.*

**Turqi, më 21 shtator 1979**

---

Në vendgërmimin e Trojës së vjetër, është ndërtuar një kalë i drunjte për turistët e ndryshëm.

## NË HORTIADIS

Mos më flisni për Hortiadisin.  
E kam njohur shumë më parë se ta shihja,  
e di vdekjen e tij.

Në sytë e dhimbshëm të tij  
kam lexuar shortet e popujve.  
I kam rilexuar përsëri e përsëri,  
dhe përsëri e kam mësuar përmendësh  
kodin tmerrësish të njohur  
të tragjedive të tyre.

Ashtu: hidhmëni recinë<sup>1)</sup> në gotë...  
Në këtë buzëmbrëmje,  
në këtë buzëdeti,  
u ngula te këmbët e kalit të Lekës<sup>2)</sup>.  
Dikush thotë se kur shante, ai shante shqip...

---

Hortiadis-i është një fshat në rrëthinat e Selanikut  
ku nazistët dogjën 144 burra dhe fëmijë.

1) lloj vere.

2) Monument i Aleksandrit të Madh në Selanik.

*Shqip kam sharë vdekjen e Hortiadisit.  
Dhe ajo, vdekja, më ka kuptuar.*

*Kurse ju... ç'do të më tregoni, ju?  
Do të më flisni për logjikën e stërplakur,  
arkaike të kimeve?  
Do të më thoni se në këto çaste kujtimi,  
si prej kësaj truporeje të bronztë në shi,  
rrjedhin rrëkerat ngashëruese të shpirtrave  
që s'i harrojmë dot kurrë? njerëzorë,*

*Unë e di formulën e gjakut të lirë të  
Hortiadisit.  
Dhe — jo nëpër afsh të verës —  
nëpër dehje të avullimit të gjakut të tij  
shoh shekullin tim.*

*Nëpër netët e lodhura të mendimeve të mia,  
si këto fjalë të rënda që ju them,  
pikon pikë... pikë... pikë... gjaku i  
Hortiadisit.*

*Në një pikë gjaku, të paktën,  
jemi të lirë, jemi njerëz.  
Në një pikë gjaku, të paktën,  
vetë vdekjes mund t'i thërrasim: — Nderoje  
vdekjen!*

*Mos më flisni për Hortiadisin.  
— E njoh, e kam parë shumë më përpara:  
ka fytyrën e përmallshme, të dhembshur,  
hutimin e pafajshëm të Borovës sime.*

*Janë dy fëmijë...  
Lëshoni në duart e tyre ndonjë lodër —  
p. sh. jetën.*

**Selanik, 18 shtator 1979**

## VARRI I GJYSHIT

*Stambolli një trëndafil i bardhë në dorë.  
Stambolli dy trëndafilë të bardhë në dorë  
Stambolli tri trëndafilë të bardhë në dorë.*

*Tri ditë që kërkoj në Karaxhaahmed<sup>1)</sup>,  
tri ditë që endem në Mezarlixhi —  
tri ditë...*

*Si ta gjej këtu varin e gjyshit?  
Këtu kohërat kanë të gjitha kuptimin e  
dheut,  
këtu kohërat shohin të gjitha me sytë e  
heshtjes.  
Sytë e mi u lodhën mbi akrepat e epitafeve.*

---

1) Karaxhaahmed dhe Mezarlixhi — janë emra varrezash në Stamboll

*As gjyshi më njeh dhe as unë e njoħ.  
I thërras me vete:  
po si mund ta dëgħojjë ai zərin tim?  
Unë i them: jam yt nip...  
Unë i them: kam ardhur nga Vlora pér ty...  
Këtu tē mbulon harrimi i tokës së huaj...*

*Në Karaxhaħħim, në Mezarlixhi... askush  
nuk përgjigjet.*

*Mbi cilin varr tē qëndroj?  
Si ky gur i rëndë, kujt t'i ngulem te kryet?  
Varret kanë nevojë pér një lule,  
varret flasin gjuhën e luleve.  
Kush mund tē më ndihmojë?*

*Orhan Veliu apo Nazim Hikmeti?  
Po ta dinin, ndofta, po t'u lutesha,  
mu në mesin e këngës së tyre  
do ta hapnin varrin e gjyshit tim.  
Ish njeri i ndershëm e tokën punonte.  
Me thonj tē gjakosur shkrifte dheun  
e diellin e nxehħtē tē Stambollit e shkrifte.*

*E Stambolli — tri trëndafilë tē bardhë  
në dorën time.*

U mbyll edhe dita e tretë.  
Syri i diellit u rrëzua pas kodrave.  
Te këmbët e mia, nëpër hije,  
përzihet muzgu i një varri të mugët.

«Abdullah...», — kushdo qofsh,  
te kryet e tu tri trëndafilë të bardhë...  
Varret kanë nevojë për një lule.

**15 shtator 1979, Stamboll**

**Skënderbeu**

---

# Uedtobandie.

## KA NJË PIKË...

*Thundra e turkut nuk shkelte tokën,  
ç'mund t'i bëj dheut një thembër kali...  
Donte të thyente kockat e popullit,  
të shqyente shpirtin e tij të bardhë.*

*Dhe shpirti dhimbjen gjer në palcë e ndjeu,  
siç e ndien guri, kokrriza e plisit.  
E lindi prej saj vetë Skënderbeu,  
u gdhend prej dhimbjes pavdekësi e lirisë.*

*Rrënja e bimës diku takon gurin,  
diku takohetëndrra e jeta.  
Dhe ndodhka ashtu, që ti edhe unë,  
si një copë buke mbajmë në dorë të  
vërtetën.*

*Ka një pikë ku puqen qielli e dheu.  
Një pikë ku shkrihen hapësirat e kohët.  
Populli? — Po ai është Skënderbeu...  
Skënderbeu? — Po ai është populli...*

## 28 NËNTOR 1443...

*Ditë-nënë që lind dielli.*

*Do të kthehëmi përsëri e përsëri tek ti.  
Pas Torviollit, Vajkalit e Oranikut,  
me zemër në dörë do kalojmë pragun  
e do hyjmë në tempullin tënd të shenjtë.*

*Me emrat e të rënëve në buzë...*

*Do vijnë shpatat e fëmijët,  
nënët, si një pikëllim i brymtë.  
Trupi yt qiellor do të mbushet  
me zëra dallëndyshesh e gruri.*

*Ditë-diell  
ku Atdheu, Liria e Jeta kanë një fytyrë.*

*Do të kthehemi përsëri e përsëri tek ti  
pas Lezhës, Krujës e Beratit.*

*Ushtarë të thjeshtë — djersë e gjak —  
do të hyjmë në tempullin tënd të shenjtë  
si një dashuri e madhe që hyn rrëmbyeshëm  
në zemër. —*

*Dhe do t'i falemi  
vetvetes.*

## LIRIA...

«Lirinë nu<sup>k</sup> ua solla unë, po e gjeta  
këtu, midis jush».

Skënderbeu

Në thëngjift e zjarrit e kafshata të bukës,  
në qiellin e syve tuaj, në këngën në buzë —  
ishte liria.

Dallgët kërkojnë oqeanet-furtunë,  
zogjt' hapësirat qiellore të lira;  
dhe varret e të rënëve bedena kështjellash  
pa gjumë —  
në një aguliçe me rrënjet në gur  
ishte liria.

Qiellin mund ta mbulojnë shigjetat e turkut,  
po dielli është prap' në vendin e tij.  
Në majën e shpatës e thikën e plugut,  
në gjirin e nënës që mendte fëmija —  
ishte liria.

Shqiponja pranë diellit fluturon në furtunë,  
në një fjalë njeriu, në një kokërr grurë —  
ishte liria.

## MBI MAJË TË SHPATËS...

«Si Ajaksi i Sofokliut, Skënderbeu u hoq nga Skena përpëra se të mbarohej akti i tretë dhe i fundmë i tragjedisë shqiptare».

Falmarajer

*Skena kishte qenë tepër e vogël,  
njaftonte një fjalë: Shqipëria...  
Po tragjedia... ishte lojtur  
në një shekull të tërë, tragjedia.*

*Kishte pasur skenat e prapaskenat,  
aktet e mëdha dhe pauzat.  
Që në tragjedi punët mirë të venë  
duhet të mbillen fantazmat.*

*Fantazma e Ballabanit shfaqej këtu e aty,  
dukej e zhdukej Moisiu, Hamzaj.  
Moisiu? — E ç'ka përt'u çuditur këtu? —  
Si meteor lirie do të digjej pastaj...*

*Dramën e loznin aktorë të mëdhenj,  
po dhe spektatorët të vegjël nuk qenë.  
Evropa pillte larva-bakej,  
që suleshin oqeanëve kope peshkaqeji.*

*Skenë të zhveshur kurrë nuk pati,  
këtë e dinte shumë mirë histori.  
Dhe me dorën e saj vendosi Venedikun, papatin,  
që të ishte e plotë butaforia.*

*Dhe drama zgjati një shekull të tërë.  
Po një shekull s'munl të jetë më yti dhe imi;  
kur përgjaket një popull një shekull — domethënë  
se aty përgjaket i tërë njerëzimi.*

*Aty përgjakeshin shekujt e shkuar,  
përlesheshin të tjerë e të tjerë që vinin.  
Ajo ishte tragjedia e madhe e lirisë...  
Dhe kishte për skenë Shqipërinë.*

*Mbaroi dhe akti i fundit. Ra sipari.  
Pastaj? — Heshtje... dhe heshtje... Heshtje?  
Prijësi i madh i lirisë nga varri  
përgjonte mbi fatin e popullit. Aty ishte...*

*Aty ishin ata që e kishin luajtur dramën një herë,  
që e kishin hequr vallen mbi majë të shpatës.  
A e keni parë ju diellin prej territ kur del? —  
Ashtu do të digjeshin ata  
dhe do të dilnin prej natës.*

## ISHIM NE . . .

*Ashtu thonë: jeniçerët ishin...  
Jeniçerët, — thonë, — e zhvarrosën atë var.  
Që pastaj fushave të luftrave të suleshin,  
varur qafës kockat e Kastriotit talisman.*

*Po ishim ne këtu, gjëmim i përjetshëm i këtij dheu.  
Diku nëpër trup, nëpër gjakun tonë, nëpër shpirt,  
ndezur prush ashkëlat e shenja të Skënderbeut.*

*Ishim ne ata që do të niseshim përjetësisht  
nëpër udhët e përgjakura, tragjike të lirisë.*

*Jeniçerët ç'mund t'i bënин Burrit të Dheut?  
Ishim ne, të djeshmit, të sotmit të nesërmët —  
ishim ne Skënderbeu.*

## ALBULENA

Eshtë po ajo krismë e thyerjes së shpatave e  
trupave, krismë e thyerjes së kockave njerëzore të shpirtit.  
Gryka e Matit rrëmben rënkin min e fundmë  
të turqve, të arbërve e thëthin Tumenishti.

Gruaja ecën mbi heshtjen e thellë të fushës së luftës.  
Ulet mbi gurë, lë në tokë torbën e bukës për të shoqin. Zgjidh litarët kurrizit.  
Merr foshnjën ndër duar, nxjerr gjirin e fortë — i jep sisë...

Te këmbët e saj fusha e luftës e gjerë  
me zëra njeriu thérret: Albulenë... Albulenë...

## VRANAKONTI...

*Ai ishte kudo ku ishte rreziku,  
ku vdekja osmane me thëllime korrte.  
Në natën tradhtare Hamzaj iku...  
Shqipëria pyeste: — A është Vranakonti?*

*Të tjerët kishin kështjella, principata,  
kishin kohortat e tyre, ushtërira.  
Ai kishte vetëm zemrën e shpatën...  
Shqipëria kishte edhe vdekjen e tija.*

## SULLTAN MURATI DHE SHQIPTARI

*Sulltan Murati qëndroi para robit të lidhur.  
Nga majat e malit e peshoi me sy:  
moshën e thyer, plagët, zinxhirët...  
— Arnaut, pastaj pyeti, përse lufton ti,  
kur mund të jetojë dhe ndryshe?  
— Sepse, padishà, u përgjigj robi,  
çdo njeri ka në kraharor një copë qielli  
dhe në të fluturon një dallëndyshe.*

## LEKË DUKAGJINI

*Kohërat gdhendën e gdhendin. —  
Ai është atje, në zemër të shkëmbit,  
Njërin sy shqiponje e tjetrin dhelpre.  
Gjuhën vetëtimë, me flakëza nepërke.*

*Mbi opingat e tij ai shkel si mbi natën.  
Pusirat i ngreh e i shkreh në bisht të mustaqes.  
— Jo Skënderbeun? — Po aherë Zaharinë...  
Dhe mbi trupin e Lekës<sup>1)</sup>) — sytë e Lekës do qajnë:  
njëri — Drin i Zi,  
tjetri — Drin i Bardhë.*

*Ai gjithë kohën lahet e shplahet.  
Me një dorë — tjetren. Me të dyja — fyrrën.  
Natyrisht, që në kthetra nuk e hedh dot Danjën;  
por edhe nga kthetrat s'do ta lëshojë kurrë.*

---

1) Lekë Zaharia i Danjës u vra në pusi

Një stërgjyshin e tij e dogjën të gjallë malësorët!  
Thonë se prej France këtej kishte dalë.  
Pse të mos jetë edhe ashtu, gjersa prej Labradorit,  
në grykë të Bunës rrëshqet një ngialë?  
Lekë Dukagjini është princ feudal:  
dhe për të lëkura e zhubravitur e një malësori  
shitet të paktën sa lëkura e një keci të tharë.

Njëren palë të brinjëve e kruan nga turku,  
tjetren brinjë e kashais nga Venediku.  
— «Skënderbeun, — thotë — e kam në shpinë...».  
Në shikimin e tij, ku thua se perëndon Perëndimi,  
kryqëzohet vetë kryqi dhe Jezui i fikur.

Ndër princërit shqiptarë ai është më katoliku,  
dhe si katolik — më oksidental.  
E apo del prej kishe, anatemën e papës,  
e mban në dorë si qeleshen e bardhë.

Po është ai që, kur vdiq Skënderbeu,  
kur e pa Gjergjin shtrirë para tij,  
me klithma që çanin qiellin e dheun,  
thirri: — Oh, mjerë ne! Dhe mjerë Shqipëria!

Dhe me dorën e tij uli kryet e maleve.  
U tha: «— Përgjunjuni si fëmija para prindit.

*Me shpatën e lirinë tuaj përfaluni,  
sot ju dhe liria mbetët jetimë».*

*Dhe ballin pështetur te cepi i arkivolit  
ai gulçonte «— Po tani kush ngeli?»  
Dhe nga sytë e Dukagjinit lotët rrondhën  
të kthjellët, të kthjellët si përroje qelli.*

## 28 KORRIK 1455<sup>1)</sup>

... Këtë ditë si Rozafën  
muroseni themelit në kështjellë.  
Dhe vetëm gjirin ia lini pak jashtë —  
gjaku i Muzakës të rrjedhë.  
Do vijnë ditë të tjera.  
aty të pinë paprerë.  
Do të jenë ato ditë-Vajkal,  
Albulenë  
do të jenë...

---

1) Dita e «Tragjedisë së Beratit».

## VRASJA E TËTË OFICERËVE TE SKËNDERBEUT

Ishin: Moisi Golemi i Dibrës, Vladan Jurica, Muzhaqi i Angjelinës, Gjon Muzhaqi, Gjon Perllati, Nakkollë Berishta, Gjergj Kuka dhe Gjin Maneshi.

*Ajo natë do të zgjaste 15 ditë e 15 net.  
Do të nderej prej Stambollit e gjer tek  
brigjet e mia.  
Do të mbuloheshin me të Ballkanet e  
Vardari  
do të mbështillej në të Shqipëria.*

*Yjet — pa dritë. Udhët — pa ecje.  
Këngët brenda tyre s'do të ishin më këngë.  
Asjeta s'do të ishte më jetë.  
As vdekja s'do të ishte më vdekje.  
Vetëm dhembja do të mbetej dhembje.*

*Do të kishin dhembje njerëzit e shpatat.  
Do të përkuleshin, do të lakoheshin kur  
shkonin tokës.*

*Dhembja do të shtrihej hapësirave,  
do të ndrydhët distancave,  
do të ndrydhët diku reliefet e kohës.*

*Sulltan Mehmed i II rrropi të gjallë.  
Njerëzit rrropi... Po qiejt a rripen?  
Thelat e tyre ua hodhi qenve t'i hanë...  
Të hanin zjarret e Krujës, Sfetigradit,  
Beratit e Dibrës.*

*Po qentë, si bisha që ishin,  
shtazërisht shihnin në sy  
kryezotin e tyre — sulltanin.  
Langonjt' mund të rrufitnin gjakun e  
mishin  
po zjarret dot nuk i hanin.*

*As stuhitë e Ballkanit e lavdinë e Krujës,  
rendjen e Vardarit e gjëmimin e Tunës,  
trumbetat e sulmit, drejtësinë e bukës,  
hakmarrjen e shenjtë të lirisë e të luftës.*

*Qentë në sy shihnin kryezotin —  
sulltanin...  
Në 15 ditë mund të hanin 8 njerëz,*

*po popuj e popuj, në shekuj e shekuj, —  
ata si t'i hanin?*

*Ajo natë zgjati 15 ditë e 15 net.  
Dhe aherë ndodhi ajo që s'kishte ndodhur:  
dhe gjethet e gjelbra të ullinjve të mi të  
urtë e të qetë,  
gjethet e vogla, si fjalë vocërrakësh vetë —  
u drodhën. Dhe nga dhembja e nga urrejtja  
— në një çast — nëpër ajër, u kthyen  
në thika të mprehta.*

## URDHRI I SKËNDERBEUT

«Çdo djalë e vajzë që martohet  
të mbjellë 25 rrënje ullinj...»:

Skënderbeu

Vdekja vinte me hapin e vdekjes,  
Nga shtrati ku dergjej ai e pa:  
vdekja vinte e flâtrat e kohës kërcitën  
nën ecje të saj...

Ai zgjati dorën e shkroi:  
— «Çdo djalë e çdo vajzë që martohet,  
të mbjellë 25 rrënje ullinj...».

Buluruan shpirtrat e Krujës e të Vajkalit,  
kambanat e bronzta të qiellit,  
kushtrimet e netëve,  
varret e të rënëve:

«25 rrënje ullinj...».

Me kokat tona osmanët ngrenë piramida,  
kockat na i thyejnë me çekan.

*I brymtë, tis nusërie derdhet mbi ju  
shpirti i Arbërisë fluror e i bardhë.*

*Ata djegin grurin,  
hardhitë si koka fëmijësh i presin, —  
dita gërmadhë, e nata gërmadhë!  
Po jemi ne  
që i ndiejmë ullinjtë kur qeshin;  
po jemi ne  
që i kuptojmë ullinjtë kur trishtohen e qajnë.*

*Jemi ne varri i osmanit, jo toka!  
Shekulli ecën me potkonj gjysmëhëne...  
Mehmedi II mund të plugojë shtëpitë  
tona —  
po shpirtin ulli t'atdheut s'e shkul dot nga  
rrënjet.*

*Vdekja po vinte me hapin e vdekjes.  
Mbi fullimin e kohës që kërciste nën ecje të  
ai zgjati dorën... damarët e fryrë të  
saj gjakut —  
rrënje ullinjsh...*

*Nën hije të tyre,  
te kryet i rrinte Donika.*

## VDEKJA E SKËNDERBEUT

*Dhe ju mos më thoni që dielli s'vdes —  
se do t'ju përgjigjem: vdes njeriu.  
Mos më thoni që oqeani s'fle —  
se do t'ju them: fle njeriu...*

Duke mbajtur përsipër peshën e asaj vdekjeje — ata lëviznin jetën, që diku kishte ngelur.

## S'ISH RËNKIM, PO PAL GOLEMI

Populli

*S'ish rënkim, po Pal Golemi  
që m'u thoshte shokëve:  
— Jeta është jetë e ëndërr,  
siç është guri gur e palcë,  
siç është fjala fjalë e bukë,  
siç është qielli terr e dritë.*

*Merreni ju shpatën time,  
vareni mbi majë lisi.  
Kur të fryjë murlani i egër,  
dhe dita të ngryset natë,  
teh i saj shkrep vezullimet,  
porsi shkrepëtima qielli. —  
N'atë dritë  
udhën gjen  
jeta vetë e vjen tek ju....*

*S'ish rënkim, po Pal Golemi.  
Te këmbët e tij vetë dielli  
kështe marrë kokën ndër duar  
edhe qante për njerinë...*

*... Do të qante gjithë jetën.*

## PO TROKAS NË ZEMRËN TËNDE...

*Po trokas në zemrën tënde,  
hapma derën, zonja ime!  
Kaloj pragun dhe hyj brenda.  
Dua që të kem mbi krye  
hapësirë, erë yjesh;  
të shikoj rrëketë qiellore  
se si lozin gjithë dritëza  
burimit të syrit tënd.  
Dhe si luftëtar i varfër,  
që mbështet kokën mbi gurë,  
gjersa të nisë prapë lufta —  
dua kryet ta pështes  
mu mbi gjoksin tënd prej dielli,  
  
... dhe të marrë, moj, një sy gjumë.*

## ATA

Gjer tek ne erdhën emrat e princërve,  
erdhën emrat e gjeneralëve —  
si vijnë me stuhi të Artikut  
brerimat e breshërit të bardhë.  
Trokasin në vargje e dritares në xham:  
herë duken, herë zhduken...  
Dhe prapë aty janë.

Po ata të panumërtit që emër nuk kanë...  
Që në thirrjen e Gjergjit për lirinë ranë...  
Që ishin dhe shpatë dhe prazmore e lirisë -  
ata ishin buka dhe gjaku i Shqipërisë.  
Ata ishin lindja, ata ishin vdekja —  
dhe në fund të fundit — ata ishinjeta.

Ata të panumërtit që shenja nuk kanë,  
që ranë brinjave e përrojeve ranë;  
që hynë nën dhé e prap' s'patën varr,  
se pati e s'pati dikush që t'i qajë...

*Kokrriza rëre — ata katundarë.*

*Murmurimë ere — ata qytetarë.*

*Një Ded' e një Dod', një Gjet' e një Uk',  
që dhe kur mbetën (si mbetën në luftë),  
në pllajë të një kënge diku të përgjakur,  
mbi ta historia si shpend grabitqar  
u ul e sqepoi shekuj e shekuj...*

*Sqepoi mbi emra, sqepoi mbi germa,  
dhe emra e germa erozioni u hëngri.*

*Dhe mbetën ata të paemërtit e vdekur...*

*Ata që ishin buka dhe vera  
dhe fjala e urtë edhe kuvendi;  
ata që ishin nderi  
dhe vendi.*

*Ata që s'kérkuan me majë të shpatës  
t'i luajnë, t'i zhvendosin historisë ndonjë  
germë,  
e për veten e tyre të hapin vend pakëz  
sa të hyjnë brenda.*

*Tani, histori, ti më thua: «ata»!*

*një moshë, një mendim, një pamje: - «ata»...*

*Dhe «ata» janë një:*

*një moshë, një mendim, një pamje: —  
«ata» ...*

*Në trupin tënd shekullor, mijëvjeçar,*

*histori — t'i ruajte për ta,  
vetëm aq vend ku të shtrihen «ata».*

*Dhe unë tani mëshirë s'kërkoj,  
as drejtësi tjetër s'dua prej teje.  
Po vetë ky varg qysqi qëlloj,  
goditi mbi fjalën «ata» që ta thyejë.*

*Dhe dalin prej saj njerëzit e varfër,  
mizëri fusha, mizëri mali;  
që digjen vetë — e zjarr s'kanë në vatër,  
që janë buka — e bukë nuk kanë...*

*Po janë Torviolli, po janë Vajkali...  
Ata që i shtypte dhe feudali,  
nga tri lëkurë u rripte tregtari;  
që shpirtin e gjallë ua peshonin me gisht,  
një babune drithë  
dhe kish edhe s'kish...*

*Po ishin ata tmerr i Turqisë,  
një babune drithë  
Krujë e pamposhtur e Shqipërisë —  
ata ishin vetë tragjedia e Beratit.*

desigen der ersten drei spätmittelalterlichen

Drei Jahre nach dem Tod des Kaisers  
als erzbischof von Salzburg bestätigt.  
Wo sonst war er zu dieser Zeit?  
dort, wo ihm die Mutter als im Frieden

Drei Jahre nach dem Tod des Kaisers  
wurde er zum Erzbischof ernannt;  
die Thronfolge war dann eine lange...  
... und langsame Sache.

Wo sonst kann er gewesen sein? Würde  
der Erzbischof die Tatsache  
daß er die Thronfolge inzwischen verloren hat  
nicht die Leute auf besondere Weise  
aufmerksam gemacht?

Wo kann die Thronfolge in Trier  
jetzt eigentlich stehen?  
Könige oder Prinzen könnten es geworden  
zu einem Mann, der nicht mehr lebt?

## PËRMBAJTJA

### I. ISHTE KOHA KUR STATUJAT KISHIN FRÍKE

Djalit tim që luan me pëllumba.	5
Drejt Shqipërisë	7
Unë jam qyteti im	10
Duke dalë prej ëndërrës	13
Fokisti Ukë dhe Prometeu	14
Ishte koha kur statujat kishin frikë	16
Për nënën time	18

### II. NË VARREZAT E DËSHMOREËVE NË VLORE

5 Maj	23
Panajot Papa	27
Dhimitër Sallata	24
Hajro Çakërri	30
Kujtim Hoxha	34
Gogo Mati	37
Nëna	39

### III. PULËBARDHA E NGJESHI GJURMËN

Patjetër	49
Pulëbardha e ngjeshi gjurmën	50

E njoh ecjen tënde .....	51
Me ty unë prapë jam mall .....	52
Në shtëpinë e vjetër .....	53
Shkëmbi i Vajes .....	54
Unë nuk e dua Akilin .....	57
Korbi .....	58
Kulloj vjeshtë i tëri .....	59
Eshtë një tjetër .....	60
Dhe ishte një lodër .....	61
Ku m'i çon shiu trishtimet? .....	62
Bariut 18-vjeçar nga Tarazhi. ....	63
Përse paskam frikë t'i afrohem detit? .....	65
Sytë e tu .....	66
Brenda syve të tu fluturojnë zogjtë e detit .....	67
Në kafé «Tirana» .....	68
Të kam takuar në të ardhmen time .....	69
Te gryka e Akerontit në Bistricë .....	70
Shifrën tënde XX e vara në varësen e derës .....	71
Nxënësit e fshatit Priskë vizitojnë sallat e Bibliotekës Kombëtare .....	72
Vajza me portokalle .....	75
Eshtë ajo dashuria .....	76
Në Korçë, pa ty .....	77
Përse e trishton dashurinë? .....	78
Besim në njeriun .....	79
Grua, lermë të luaj me guralecët .....	82
Ti do t'më dashurosh patjetër .....	85
Lumit ... .....	86
Romeo dhe Xhuljeta në shpellën e Gadimës .....	91
Në Trojë... .....	92
Në Hortiadis .....	95
Varri i gjyshit .....	98

#### IV. SKËNDARBEU

Ka një pikë .....	103
28 Nëntor 1443 .....	104

Liria .....	106
Mbi majë të shpatës .....	107
Ishim ne.. .....	110
Albulena .....	111
Vranakonti .....	113
Sulltan Murati dhe shqiptari .....	113
Lekë Duḱagjini .....	114
28 korrik 1455 .....	117
Vrasja e tetë oficerëve të Skënderbeut ....	118
Urdhri i Skënderbeut .....	121
Vdekja e Skënderbeut .....	123
S'ish rënkim, po Pal Golemi .....	124
Po trokas në zemrën tënde .....	126
Ata .....	127